

V E N D I M

Nr.675, datë 26.10.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.551, DATË 28.8.1998 “PËR VEPRIMET E KTHIMIT TË ARIT TË GRABITUR NGA GJERMANËT GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE”

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.551, datë 28.8.1998 “Për veprimet e kthimit të arit të grabitur nga gjermanët, gjatë Luftës së Dytë Botërore” pika 1 ndryshohet si vijon:

“Sasia e arit prej 49 804,314 (dyzet e nëntëmijë e tetëqind e katër presje treqind e katërmëdhjetë) onc ar i pastër, prej të cilit 31 168,508 (tridhjetë e njëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje pesëqind e tetë) onc lingota dhe 18 635,806 (tetëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë presje tetëqind e gjashtë) onc, në formën e monedhave metalike, dorëzuar Palës shqiptare më 29 tetor 1996 nga komisioni tripalësh dhe sasia prej 1 571,543 (njëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një presje pesëqind e dyzet e tre) onc ar i pastër, së bashku me shumën 2 106, 24 (dymijë e njëqind e gjashtë presje njëzet e katër) stërlina angleze, dorëzuar me 13 korrik 1998, të kalojnë në rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko